

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. SHKELZEN SELIMI

07/30/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 27.07.2018 për subjektin e rivlerësimit, z.Shkelzen Selimi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 30.07.2018, vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit , Shkelzen Selimi, gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjykuese e kryesuar nga znj. Etleda Çiftja, znj.Valbona Sanxhaktari relatores, znj.Xhensila Pine anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.